




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	20/DPK	Nr Prot.	01-4018/15
Dep.		Bi Prot.	
Nr. I faq		Prot No.	
Broj stranica	02	Data	09.11.2015
Nr. pages		Datum	
		Date	
PRISHTINE			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.11.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2934 -15 për z.Gzim Kllokoqi – Zyrtar Kryesor Financiar në “Stacioni i Autobusëve” Gjilan, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë z.Kllokoqi ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në një biznes privat, duke shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2934-15, për Zyrtarin e lartë, z.Gzim Kllokoqi–Zyrtar Kryesor Financiar në N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” Gjilan, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Kllokoqi është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (ZD/DPK-01-3004/15), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç’rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Kllokoqi , është deklaruar se do t’i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell një shkresë përcjellëse (njoftim) si dhe shkresën zyrtare nga Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) “Informata mbi biznesin”(DPK/DPKI-03-02-3734/15), në të cilën shihet se z.Kllokoqi tashmë ka heq dorë

nga ushtrimi i funksionit të personit të autorizuar në biznesin; N.t.sh. “Business Power”, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

